


# Letersia 1

## 1.Zanafilla e folklorit.



Me folklore kuptojme krijimtarine gojore ose letersine gojore te nje populli.

Folklori karakterizohet nga:

- ♣ Anonimati(mungesa e emrit te autorit ose autoreve)
- ♣ Ka nje karakter kolektiv ose kolektiviteti,qe do te thote eshte fut I nje pune krijuese te disa njerezve.
- ♣ Moterzimet (variante te ndryshme)
- ♣ Improvizimi (te krijuarit e dickaje aty per aty)
- ♣ Sinkretizimi(bashkim I njekohshem I elementeve te ndryshem.
- ♣ Tipari teatror(vecoria qe kane krijimet folklorike per tu vene ne skene.

## 2.Lidhjet e folklorit me elemente te tjere.

Folklori lidhet edhe me elemente te tjere sic jane:

- ♣ Gjuha (pra fjalen te cilen e perdor si mjet artistic)
- ♣ Muzika (melodine me te cilen I jep force artistike dhe ritmin \_
- ♣ Korografia (vallet te cilat plotesojne sinkronizimin)
- ♣ Zakonet
- ♣ Historine
- ♣ Psikologjine..etj

## 3.Llojet e muzikes popullore

Cdo kenge ka ndertimin e saj te brendshem I cili lidhet me:

- ♣ Llojin e melodies
- ♣ Menyren e te te kenduarit te kesaj melodie nga nje ose me shume njerez
- ♣ Ritmin e perdorur
- ♣ Shoqerohet ose jo me instrumente muzikore.

Ka dy menyra te te kenduarit:

- ♣ Me shoqerim instrumental
- ♣ Pa shoqerim instrumental

Keto ndahen ne :

- Tipi monodik (kur nje linje melodike kendohe vetem nga nje njeri
  - Tipi homofonik(kur e njejta linje melodike kendohet nga dy ose me shume njerez ne unison (duke kenduar te gjithe zerin e pare)
  - Tipi heterofonik(kur disa njerez pasi nisin kengen ne unison fillojne te ndajne melodite
  - Polifonia labe .kendohet nga keter sera ku dallohen
1. Marresi (ai qe e nis dhe udheheq kengen )
  2. Kthyesi (merr I pari mesazhin dhe mbeshtet fjalet e marresit)

3. Hedhesi (rimerr nje pjese te vargut dhe e vazhdon me tej )
4. Mbushesit(mbajne iso duke kenduar nga nje note te vetme)

Nder veglat muzikore me te perdorura ne vendin tone jane:

Lahuta ,llahuta ciftelia bozoku,fyelii ,biculja ,gajdja,qypi,dajrja,daullja.



## 4.Vallet popullore

Valet e popullit tone jane te shumta e te ndryshme .Ato luhen te shoqeruara ose jo me vegla muzikore.Luhen me te gjitha pjeset e trupit duke perfshire edhe mimiken e fytyres.

Disa vecori te valleve shqiptare jane:

- ♣ Valet shqiptare jane te gjalla.
- ♣ Luhen nga nje grup valltaresh ,por edhe nga nje individ I vecante.
- ♣ Valltaret shqiptare I luajne valet me te gjitha pjeset e trupit ,ndryshe nga ata serbe qe levizin kryesisht kembet.
- ♣ Valltaret shqiptar kapen nga duart ose I hedhin krahun njeri tjetrit.
- ♣ Dallimi qendron edhe midis valleve te fushave dhe atyre te maleve ku valet e fushave kane me teper levizje horizontale kurse at ate maleve me shume vertikale

Valet I ndajme ne epike dhe lirike ku vete liriket ndhen ne :

- ♣ Vallet e dasmave
- ♣ Vallet e dashurise
- ♣ Vallet komike
- ♣ Valet e riteve te ndryshme

Nderkaq nder kostumet popullore me kryesore permendim:

- ♣ Veshje me fustanelle
- ♣ Veshje me dolloma
- ♣ Veshje me tirq
- ♣ Veshje me poture
- ♣ Veshje me brekushe
- ♣ Veshje me xhublete
- ♣ Veshje me kemishe te gjate e xhoke
- ♣ Veshje me kemishe te gjate e dy futa
- ♣ Veshje me mbeshtjellese

## Ndarjet e folklorit

Materialet folklorike ndahen ne tre gupe te medha qe jane:

- ♣ Lirika
- ♣ Epika
- ♣ Teatri folkloric

Lirika shpreh ndjenjat dhe perjetimet shpirtore te njeriut.ndjenjat qe shprehen ne lirike jane te ndryshme si :dashuria ,gezimi,urrejtja ,hidherimi,miqesine,etj.Disa prej tyre jane:

- ♣ Ninullat
- ♣ Kenget e dasmave
- ♣ Kenget e dashurise
- ♣ Kenget e riteve te motmotit

Epika eshte ajo gjini e letersise e cila mbeshtetet ne tregimin ose rrefimin e ngjarjevedhe jetes se njeriut.Ne to hyjne:

- ♣ Perrallat
- ♣ Kenget legjendare te cilat ndahen ne :kenget e murosjes,kenget legjendare te vellait te vogel,kenget klegjendare te rinjohjes
- ♣ Kenget historike

#### Perseritja epike

Ne kenget epike shpeshhere perseriten disa vargje ne pjese te ndryshme te tregimit .Nje perseritje e tille I jep tregimit nje fryme me popullore dhe e mban me te gjalle.

## Kenget legjendare te ciklit te kreshnikeve

Cikli I kreshnikeve perbehet nga nje varg rapsodish ne te cilat tregohen bemat e dy heronjve ,Muji dhe Halili.Lindja e ketij cikli mendohet te datoje rreth shekullit XI-XII.Keto kenge kendohen vetem ne zonat veriore te Shqiperise ,si dhe ne zonat kufitare .Karakteristike e ketyre eshte fakti qe ngjarjet dhe njerezit sillen te hiperbolizuara,si dhe perzihen me qenie mitologjike si Oret e Malit.Nder personazhet kryesore permendim :Muji,Halili,Ali Bajraktari ,Zuku Bajraktari,Krajli,Ajkuna,Tanusha etj.armiku me te cilet luftonin kreshniket eshte kurdohere sllavi apo veglat e tij. NE cilklin e Kreshnikeve shquhen per nga bukuria disa rapsodi si: "Martesa e Mujit" "Muji e Behurit", "Omeri I ri", "Zuku Bajraktari" "Ajkuna dhe Omeri"

## Personazhet dhe vecorite e kengeve te kreshnikeve



Ne keto kenge tregohen bemat e nje familjeje te ndihuar nga burrat dhe grate e gjithe fisit .kjo eshte familja e nje lopari ,Mujit nga Klladusha dhe e Halilit,e gruas apo motres se tij Ajkuna etj..Ka shume element qe deshmojne se kemi te bejme me nje periudhe te patriarkatit,por edhe elememnte te tjere qe tregojne per nje periudhe me te lashte ,pra matriarkatit.

Muji eshte nje trim I urte ,I matur ,baba I dhembshur ,vella I dashur por edhe nje bashkeshort I kujdesshem .Ai eshte misherimi I gjalle I kanunit te maleve.

Halili ,deri diku eshte nje figure qe qendron ne antiteze me villain e tij por edhe e ploteson figuren e Mujit,Ai eshte I pashem gjaknxehte ,zemerak dhe po aq trim sa edhe vellai I tij

## Figurat letrare

Anafora –ne folklore perdoret shume anaphora e cila u jep muzikalitet dhe kumbim vargjeve ,ajo ndertoht duke duke perseritur nje fjale ose disa fjale ne krye te disa vargjeve me rradhe

“Kah kerkova gjithkund bjeshke.....

Kah verova gjithkund.....

Kah mjerova gjithkund.....”

Hiperbola –shprehje figurative qe zmadhon se tepermi njerezit ,veprimet e tyre ,dukurite e ndryshme .Perdoret per ta forcuar me teper figuren kryesore dhe per te dhene me shume pershtypje.

Epanostofeja –figure letrare gjate te ciles vargu l dyte fillon me fjalen me te cilen mbaron vargu l pare.

“edhe l nuse e paska zene

Zana e paska t’bijn e krajlit”

Aliteracioni –nje mjet per zbukurimin e vargut ,dmth perseritja e te njejtis tingull brebda nje vargu

“ka kalue katue e kasaba”

“bini n’pije e pijen po ma pini”

Forma vargjesh

a) perseritet e njejta fjale ne fillim e ne mes te vargut

b) gjysma e pare e vargut ben rime me gjusmen e dyte te vargut

c) vargu I pare ben rime me gjysmen e vargut te dyte

ka raste ku dy ose me shume vargje mbarojne me te njejten fjale, kjo per ti dhene me shume muzikalitet

## Elementet e analizës së tekstit letrar

### Kenget historike

Ne kenget historike populli un kendon ngjarjeve dhe personaliteteve historike .Kenget historike lidin ne menyre te natyrshme ,te krijuara shpeshhere edhe nga vete pjesemarresit ne keto ngjarje historike. Ne kohen e Skenderbeut linden padyshim shume kenge per luften e shqipetareve kunder pushtimit ottoman ,nen udheheqjen e skenderbeut. Megjithate duhet thene se keto kenge historike per shkak te kohes se gjate qe ka kaluar kane marre nje fare ngjyrimi emocional. Shembujsh kengesh te tilla mund te permendim: skenderbeu vendos te marohet, Ky Uran I pare ne Krue ,me njezet e tete nentor, Kenga e Luftes se Kosoves ne vitin 1389”

### Komunikimi letrar

### Faktoret e komunikimit



Qe komunikimi letra te realizohet jane te domosdoshem faktoret e meposhtem

-dhenesi:ai qe formulon mesazhin


-marresi:ai qe merr mesazhin

-kodi:sistemi I shenjave ,I simboleve konvencionaleve dhe I rregullave qe mundesojne kombinimin e tyre

-mesazhi:teresia e frazave qe dhenesi formulon Brenda mundesive qe ofron kodi

-kanali:mjeti fizik I transmetimit te mesazhit (valet zanore,kabloja e telefonit)

Letersia eshte nje forme komunikimi .Qellimi komunikativ eshte I perfshire ne vete faktin qe nje veper I drejtohet nje publiku me permasa te paparashikuar



E para gje qe dallojme eshte se ne komunikimin letrar dhenesi (autori) e marresi nuk jane te bashkepranishem pra u takojne koherave te ndryshme

Ne vepren letrare dhenesi eshte autori dhe marresi eshte lexuesi

Komunikimi vepron vetem ne nje drejtim

Mesazhi duhet te jete sa me I kuptueshem

Konteksti te perfshije sa me teper mesazhin

Kodi gjuhesor te jete I pajisur me aparate shpjeguese ,te jete I pershtatshem per lexuesit e cdo kohe

Ndryshe nga komunikimi gojor ai letrar ka perpareisne se tekstit te shkruar mund ti rikthehesh per ta kuptuar me mire

Kritiku letrar hap rruge per pervetesim teresor te mesazhit

Lexuesi mund te shfryrtezoj informacione plotesuese per ta kuptuar me mire

## Funksionet e komunikimit

Nese ne plan te pare del dhenesi I mesazhit me idete dhe emocionet e tij ,themi se kemi funksion emotive (emocional)

Nese theksi bie mbi marresin me qellim qe tia kushtezoj sjelljen ,qendrimin do te kemi nje funksion nxites

Kur ne drite te vecante del konteksti ,komunikimi fiton nje funksion kryesisht referues

Ne qofte se synohet te verifikohet qendrueshmeria e kontaktit,kemi nje funksion fatik(nga latinishtja fati=folur)

Kemi funksion metalinguistik te komunikimit nese ne plan te pare del kodi (pra nese flitet per gjuhen me ane te gjuhes)

Po qe se ne qender te vemendjes vihet mesazhi si I tille ,pra si nje teresi fjalesh te pajisura me nje paraqitje te caktuar formale,jemi perballe funksionit poetic

Funksioni emocional shfaqet atehere kur nje autor shkruan per te shprehur boten e tij emocionale ,per tu vete rrefyer.

Funksion nxites kemi kur shkrimtari perms veprave te tij synon ta orientoj lexuesin ,tja kushtezoj atij qendrimin ,sjelljen.Ta nxis ate qe te realizoj nje qellim te caktuar.

Funksioni referues mbizoteron kryesisht ne veprat historike ,filozofike,por ka raste kur shfaqet dhe Brenda veprash letrare,kur pershkruhen zakonet e ritet ne udhershkrimet letrare.

Funksion fatik eshte me pak I hasur meqe sic treguam me lart komunikimi letrar nuk lidh ne menyre te drejperdrejte dhenesin me marresin.

Funksioni poetic eshte funksion qe e percakton komunikimn letrar sit e tille:mesazhiorganizohet per nga forma me elemente gjuhesor e stilistike qe I bent e jete ndryshe nga komunikimi I perditshem .

## Leximi I tekstit letrar

Per ta bere sa me te frytshem leximin e tekstit letrar duhet punuar me vepren letrare ne dy drejtime:

Se pari te cmontohet teksti ne pjeset e tij perberese per te pare se si eshte ndertuar ai ,per ti vecuar elementet qe realizojne kete nderim kompleks.

Se dyti ,te rivendoset teksti ne situaten komunikative qe e ka krijuar duke e lidhur me te gjitha hapsirat historiko-kulturore te mundshme

Leximi eshte nje veprimtari mendore qe perfshin procese te ndryshme njohese.Me se pari ai eshte nje veprimtari strukturore qe bazohet ne vendosjen e perberesve te tekstit ne raport me njeri-tjetrin.

Ne nje tekst te shkruar nje element I rendesishem eshte edhe kompozicioni ,pra menyra se si eshte nderuar ai.Gjithashtu nje tekst eshte edhe shprehje e nje culture dhe e nje realiteti historiko shoqeror.Ne kete menyre leximi letrar pushon se qeni nje veprimtari thjesht njohese dhe kthehet ne nje mjet mjaft te fuqishem te rritjes dhe persosjes shpirtore dhe intelektuale.

## Konteksti historiko-letrar

Te analizosh nje tekst do te thote ta historizosh ate;ta rivensosesh ne situaten fillestare kohore,ne te cilen eshte krijuar duke I pare te gjithë faktoret e komunikimit

Dhenesi.Rindertoet figura e dhenesit ,personaliteti psikologjik e moral I shkrimtari ,zbulohen idete e tij per boten dhe per artin

Marresi ,Po aq I rendesishem eshte edhe percaktimi I marresi historic te vepres ,lexuesve te cileve u drejtohet vepra

Kanali.ka raste kur studimi I tekstit letrar kerkon te studiohet edhe kanali I shfrytezuar per komunikimin e tij .Kalimi I vepres nga nje shtypshkrim I kushtueshem ne nje shtypshkrim mformatesh te vogla ndikon ne vete tekstin.

Konteksti .Me kete terme do te kuptojme nje teresi elementesh te cilave ne menyre te drejtperdrejte ose te terthorte ju referohet teksti.

Mund te dallojme tre tipa kontekstesh:

Kontekstin letrar,kontekstin ideo –kulturor,konteksti historiko –shoqeror

Konteksti letrar eshte ai qe lidh veprat e te njejtit autor ,te autoreve te afert me te per nga prirjet artistike e poetike,te autoreve te periudhes se tij dhe te gjithë traditen letrare te ciles ai mund ti referohet

Konteksti ideo kulturorperfshin teresine e ideve te koncepteve politike ,filozofike ,fetare te pikepamjeve per epoken qe ka nje grup shoqeror ose

nje levizje intelektuale,ne te cilen ben pjese edhe shkrimatri qe edhe ne studiojme.

Konteksti historiko-shoqeror perbehet nga struktura e shoqerise dhe nga teresia e ngjarjeve historike te nje periudhe te caktuar kohore.

## Kodet letrare

Vepra letrare eshte e hartuar ne nje gjuhe te caktuar .Gjuha eshte nje system konvencional I pranuar nga autori.

Gjuha .Natyrisht qe kodi I pare eshte gjuha dhe sidomos ai nenkod I asaj qe eshte gjuha e letersise artistike.

Stili .Ose sic quhet ndryshe rregjistri stilistik ka te beje me “menyren e te shkruajturit “.Kur flasim per aspect stilistik te nje vepre letrare kemi parasysh dy ane te tij

1.teresine e vecorive qe kakarakterizojne menyren e te shkruarit te nje shkrimtari .

2.teresine e vecorive qe karakterizojne menyren e te shkruajturit ten je grupi veprash letrare,te cilat I takojne nje drejtimi letrar,te perbashket ose te njejtit lloj letrar

Gjinia letrare eshte nje nga institutet themelore te letersise ,nje nga kodet e funksionimit te saj si e tille.Mbi bazen e saj behet lidhja e afersise midis veprave letrare qe I takojne te njejtës gjini ,lidhje qe eshte edhe me e ngushte se ajo mbi bazen e stilit.Kjo lidhje ka te beje me aspektin e formes dhe ate te permbajtjes.

## Teksti poetik

Autori ideal-ne rradhe te pare do te jete e nevoijshme qe nga teksti te nxirret profile I autorit te ntij .Ky nuk perkon me autorin historic te vepres ,por perfaqeson nje pamje te idealizuar te tij.Pra duhet dalluar autori historic

,njeri I gjalle ,konkret .qe ndryshon ne kohe ,qe ka zakonet e tij ,nga ana tjeter autori ideal nuk mund te ndryshoj me kohe dhe qe vetem pjeserisht paraqet personalitetin e tij.

Lexuesi ideal-marresi ideal I cili nuk perputhet me ate real ,eshte ai qe teorikisht zoteron ne shkalle me te larte aftesine ,shijen dhe dijen qe kerkohet per te kuptuar tekstin.

## Nivelet e tekstit

Tema e motivet

Tema e nje vepre eshte ceshtja themelore qe ajo trajton .

Motive eshte njesia me e vogel kuptimore e nje teksti.

Niveli simboliko-ideologjik.ne qender ten je vepre letrare qendron nje ide e cila zbulohet ne pjesen me te madhe nga boshti tematik .Kjo ide nuk lind ne nje truall bosh .Ajo eshte rritur ne nje system idesh qe perkojne me bindjet ideore te vete autorit

Niveli stilistik.Analiza e nivelit stilistik kerkon dallimin e atyre zgjedhjeve qe shkrimtari ka bere Brenda kuadri te institutive letrare.Pra behet fjale per figurat retorike ,pre gjinine letrare.

Niveli gjuhesor .Studimi I tekstit me kete nivel ka te beje me menyren e vecante te perdorimit te gjuhes ne aspektin morfologjik .

Niveli ritmik e metric.Eshte e qarte se se nje poezi eshe e karakterizuar nga nga nje element baze ,pra ritmi.Metrika eshte ajo dege e cila studion klasifikimin e llojeve te vargjeve ,strofave mbi bazen e ketyre elemente

# Teksti narrativ

Termi narrative vjen nga latinishtja dhe do te thote rrefej ,tregoj cka perben edhe te vecanten e ketyre teksteve.

Ai karakterizohet nga:

Kohesia –pra tregon ngjarjete cilat kane vazhdimesi ne kohe.

Rrefimtari-kemi nje ze ,nje narrator I cili merr persiper misionin e te treguarit te ngjarjes.Ai mund te jete I brendshem ose I jashtem.Kur eshte I jashtem mund te jete I veteshprehur ose I fshehur

Rrefimtari I brendshem eshte deshmitar I ngjarjes ose protagonist I saj

Subjekti –teresia e berthamave narrative perben perben subjektin e ngjarjes

Berthamat narrative-njesite me te vogla ne te cilat ndahet nje tekst narrative

Fabula-perbehet ngangjarjet kryesore te vendosura sipas nje rendi kronologjik

Anakronia –thyerje kohore qe karakterizon vepren tregimtare.

Flash-back-teknike e perdorur ne nje tekst narrative per te kthyer pas ne kohe.

Ritmi I rrefimit-raporti mes kohes qe kane ndodhur ngjarjet dhe asaj me ane te se ciles ato rrefehen.

Funksionet e rrefimtarit Brenda nje tregimi jane:

Te beje koment

Te pershkruaj

Te rrefej

Te trasmentoje ate qe mendojne personazhet

Kjo realizohet ne tri menyra :me ane te ligjertes se drejte ,ligjertes se zhdrejte ,ligjertes se zhdrejte te lire.

Sistemi I personazheve

Personazhet jane motoret e ndodhise se rrefyer.Ata mund te studiohen ne disa plane ne te cilat permblihen:

Cilesite e personazhit,tiparet e tij

Veprimtaria e tij Brenda rrefimit

Pikepamjet e tij

Ligjeratat e tij ,pra aktet gjuhesore ne te cilat ai eshte dhenes ose marres

Identifikimi I tij behet duke iu permbajtur disa niveleve

1.gjendja e tij civile

2,gjendja familjare dhe shoqerore

3.vetite morale psikologjike

4.sjelljet e tij

Pikeveshtrimi-syri me te cilin shifen ngjarjet



## Teksti teatoror



Nje veper teatore vetem nepermjet paraqitjes skenike siguron nje njohje te plote nga publiku dhe vetem nepermjet kesaj rruge arrin te realizoje te tera mundesite shprehese dhe kuptimore qe permban teksti I shkruar. Kur flasim per teater kemi parasysh nje tekst spektakolar I cili bazohet ne tekstin teatro te shkruar. Interpretimi I tij nga ana e aktoreve eshte nje tipar themelor, ashtu sic edhe reagimi I spektatorit ne permjet duartrokitjeve etj, pra kemi te bejme me nje menyre komunikimi ne dy drejtime.

Marreveshja e murit te katert bazohet ne faktin qe ne skene aktoret imitojne realitetin duke paraqitur personazhe te cilet flasin e veprojne duke u shtire ,sikur nuk duan tia dijne per publikun. KY tekst mbeshtetet mbi dialogun dhe pervec tyre jane edhe didaskalite (sqarime qe ben narrator )


## Teksti eseistik

Eseja eshte nje shkrim relativisht I shkurter I cili qendron midis letrares dhe filozofikes. nga letersia merr subjektivitetin ,kurse nga filozofia objektivitetin. ky tekst nuk u drejtohet ndjenjave por faktit dhe logjikes

Jeronin De Rada

Jeta dhe veprat.

(1814 - 1903)



1814-lindi me 19 nentor ne fshatin Maki te Kalabrise

1813-kryen mesimet ne kolegjin San Benedeto Ulanos

1834-rregjistrohet ne universitetin e Napolit ne Fakultetin e Drejtesise

1836-kthehet ne shtepi duke sjelle me vete vepren "Milosao"

1849-emerohet pedagog ne katedren e letersise se krahasuar ne kolegjin e Shen Adrianit

1850-martohet me Madalena Meklin .Me te lind 4 djem

1872-i kane vdekur te katert djemte, I vdes e shoqja dhe vellezerit

1902-le pergjithmone fshatin e tij dhe vendoset ne nje dhome me qira ne fshatin Shen Dhimiter Korona

1903-Me 27 shkurt bie ne agoni dhe vdes>ne shtratin e vdekjes therret"GJaku shqiptar po shkon!GJaku shipetar po niset.Vdiq ne te gdhire te 28-se.

Nder veprat kryesore permendim:

Odisse 1832

Milosaot 1836

Serafina topia 1839

Skanderbegu I pafane1872-73

Pelagsi e albanesi 1890

Autobiografia 1898-99

## Vepra "Milosaot"

Vepra Milosaot eshte nje poeme ose sic e quajne studiuesit ,roman ne vargje.Ne baze te kesaj vepre eshte vendosur historia e dashurise e dy te rinjve shqiptar,qe pengohet nga rrethana te ndryshme.Historia e dashurise se Milosaot,Birit te sundimtarit te Shkodres ,me vajzen e varfer Rine .Ngjarja zhvillohet ne shekullin e XV,pra ne kohen e Skenderbeut.Ne kete veper gershetohen dy tema kryesore :tema e dashurise se dy te rinjve me temen e clirimit te atdheut.Dy te rinjte takohen tek burimi I fshatit ,me pas martohen dhe lindin edhe nje femije.Por lumturia e tyre nuk mund te zgjas shume,sepse sic na meson poeti pa lumturi te atdheut ,s ka lumturi vetjake.PAsi vdes I biri dhe e shoqja e Milosaos,ky I

fundit rrok armet dhe shkon ne luftime ,ku vritet duke luftuar per atdheun. Skema e subjektit të poemës është e njohur në letërsinë sentimentale dhe romantike, një dashuri e kundërshtuar nga mjedisi.

**POESIE**  
**ALBANESI**

DI

**Girolamo de Rada**

*Μοῖσα δ' οὕτω ποιησάμενος  
Μοῖ νουσιγαλον ευρόντι τρόπον  
Δαρτὰ φονῶν εναρμόζει πεδίλων.*  
PINDARO.

PRIMA PARTE



**ΝΑΠΟΛΙ**  
STAMPERIA DEL FIBRENO  
1847

## Karakteristikat e nje tregimi.

Nje tregim eshte nje tekst i plote qe ka nje hyrje ,nje zhvillim edhe nje mbyllje,ne te veprojne nje ose me shume personazhe.Ai qe ka rolin kryesor eshte protagonist ,dhe nje tjetër qe i kundërvihet qe quhet antagonist.Personazhet here pershkruhen nga autori ne menyre te drejtperdrejte ,ose here te tjera informacionin per ta e marrim nga qendrimet ne raport me te tjeret .Rrefimtari mund te jete personazh i ndodhise :ne kete rast tregimi shkruhet ne vete te pare.Kur rrefimi eshte ne vete te trete atehere rrefimtari eshte nje vezhgues i jashtem.Ngjarjet e treguara ne tregim kane nje shtrirje kohore e cila ndryshon nga teksti ne tekst.Jo gjithnje rendi kohor i ngjarjeve te treguara perputhet me ate qe faktet kane pasur me te vertete.Kjo teknike quhet flash back.Ndodhia e nje

tregimi mund te ndahet ne pjese episode ,qe karakterizohen nga zhvendosje ne kohe dhe ne vend dhe nga ndryshimi I personazheve dhe I veprimeve te tyre.Dialogu sidomos ai I shperhur ne ne ligjirate te drejte ,me perdorimin e kohes se tashme,me riprodhimin e fjaleve te perdorura ne situaten perkatese ,ka per qellim te afroje me shume lexuesin me rrefimin.

## Ismail kadare Jeta dhe veprat



Eshte shkrimtari me I njohur dhe poeti me me ze I letersise se sotme shqiptare..Eshte shembulli kuptimplote I forces krijuese dhe I origjinalitetit te letrave te sotme shqipe.

28.01.1936-lindi ne Gjirokaster

1958 kreu studimet ne fakultetin histori-filologji

1959-studioi ne institutin Gorki te letersise boterore ne Moske

1990-largohet nga Shqiperia dhe vendoset ne France ,ku zhvilloi dhe aktivitetin e tij letrar.

**Poezia e Ismail Kadaresë është një prej zhvillimeve më novatore në vjershërimin shqip gjatë një gjysmë shekulli. Ajo shprehu vendosmërinë e shkrimtarëve të brezit të viteve '60 për të realizuar qëllime estetike të ndryshme prej paraardhësve.**

**Frymëzime dialoshare (1954), Ëndërrimet (1957), Endërr industriale (1960), Shekulli im (1961), Poemë e blinduar (1962), Përse mendoben këto male (1964), Shqiponjat fluturojnë lart (1966), Motive me diell (1968), Koha (1976), Shqipëria dhe tri Romat, përbëjnë titujt kryesorë të veprës poetike të Kadaresë.**

**Poezia e Kadaresë, ndryshe prej prozës së tij, është përgjithësisht e qartë, pa ekuivoke, shpesh marciale, thuajse përherë optimiste.:Gjithashtu poezia intime e Kadaresë përshkruhet nga malli për qytetin e lindjes, për njerëzit që lanë gjurmë në fëmijërinë e tij, për atdheun kur ndodhet larg tij, për kohën studentore, vajzat dhe rrugët e Moskës kur është në atdhe, e mbi të gjitha, për vajzën që le gjurmë në shpirtin e tij, por që përgjithësisht ndodhet larg.**

**Nder veprat me te rendesishme permendim:**

**Frymezime djaloshare 1954**

**Perse mendohen keto male 1964**

**Gjenerali I ushtrise se vdekur 1963**

**Kronike ne gur 1971**

**Kush e solli Doruntinen 1981**

**Ura me tri harqe 1978**


**Eskili ,ky humbes I madh 1990 etj**

## **Kronike ne gur**

**“Kronikë në gur” afirmohet menjëherë si vepër thelbësore në kuadrin e krejt krijimtarisë së Kadaresë. Është roman i hyrjes në jetë dhe në letërsi. Tregimtari është autori, që përpiqet të rishohë me sytë e fëmijës tetë vitet e para të jetës së tij.**

**Kronike ne gur eshte nje nder romanet me me peshe ne krijimtarine e autorit .Ngjarjet zhvillohen ne periudhen e luftes ,por romani ne vetevete ka ne qender nje kronik per qytetin piktoresk te gjirokastres.Vepra perbehet nga 18 kapituj ,nje prolog dhe I ngjan nje mozaiku pa skemen e zakonshme ndertimore.Pamjet dhe skenat e qytetit I lidh figura e tregimtarit.Ato marrin treajta te gjithfarshme dhe shfaqen here ne forma simbolike apo edhe hiperbolike.Ngjarjet rrefehen ne menyre teper naive ,por pas naivinitetitshihet ironia therese.Romani shfaq tiparet autobiografike duke rrefyer jeten e nje djaloshi neper rrugicat e qytetit te Gjirokastres,dhe ku ngjarjet shihen me syrin e femijes ,te cilit si shpeton asnje gje nga bisedat e rruges thashethemet apo edhe paragjykimet.Romani eshte perpunuar me shume dashuri dhe ndjenja humori,duke e paraqitur vepren ne menyre origjinale .Kjo lidhet edhe me filozofine e brendshme te krijimit qe perben vecorine kryesore ne stilin e Kadarese.**

## **Homeri**



## **Jeta dhe krijimtaria**

**Per jeten e homerit thuajse nuk dihet gje. Thuhet se ka jetuar rreth shekullit te IXnpara krishtit ne izmir te Turqise .Shume thone se ishte I verber por askush nuk e di ku ka lindur,megjithese shtate qytete te greqise mburreshin se kishin qene vendlindja e ketij poeti te rralle.**

## **Iliada**

**Poema Iliada flet per luften qe greket ben kunder trojaneve,lufte qe zgjati 10 vjet,megjithese ne poeme paraqiten vetem 51 ditet e fundit.Kjo lufte nisi per shkak se Paridi,I biri I Priamit ,mbretit te Trojes,rrembeu Elenen ,gruan e grekut Menelaut.Atehere per te vene nderin ne vend ,princat e ndryshem greke zbarkuan ne Troje ,dhe qendruan per 10 vjet rresht .Ne tere poemen vihet ne dukje sidomos roli I madh I njeriut trim e te forte,ne rastin tone Akilit apo Hektorit**

**Poema perbehet nga 24 kenge.**

**Personazhet**

**Personazhi eshte nje person qe merr pjese ne veprimin e ngjarjes.**

**Protagonist\_personazhi kryesor**

**Antagonist-eshte personazhi qe I kundervihet protagonistit**

**Personazh I dores se pare-eshte ai qe luan rol kryesor ne veprimtarine e ngjarjes**

**Personazh I dores se dyte-eshte ai qe luan nje rol te vogel**



## **Karakterizimi**

**Karakterizim quajme perdorimin e teknikave letrare per te dhene tiparet e nje personazhi**

- 1.pershkrimi I drejtperdrejte I karakterit nga ana e autorit**
- 2.pershkrimi I karakterit nepermjet veprimeve dhe fjaleve te personazhit**
- 3.pershkrimi I botes se brendshme te personazhit.**

Letërsia